

# Vlerësimi i implikimeve të kostove të programit të qeverisë së Kosovës



**Botuar nga:** Instituti Riinvest, Rr. Lidhja e Prizrenit nr. 56, Prishtinë 10000, Kosovë  
Tel.: + 381 (0)38 244320; 223816 [www.riinvestinstitute.org](http://www.riinvestinstitute.org)

**Me përkrahjen e:** Ky raport është përkrahur nga Konrad Adenauer Stiftung

**Mohim i përgjegjësisë:** Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të autorit dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Konrad-Adenauer-Stiftung në Kosovë. Ky botim i Konrad-Adenauer-Stiftung në Kosovë shërben vetëm për qëllime informative. Ai nuk mund të përdoret nga partitë politike ose nga aktivistët apo mbështetësit zgjedhorë për qëllime të reklamës zgjedhore. Kjo vlen për zgjedhjet federale, shtetërore dhe lokale, si dhe për zgjedhjet për Parlamentin Evropian.

E drejta e autorit © 2021 nga INSTITUTI RIINVEST. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik, fotokopje, incizim apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.

# Table e Përmbajtjes

Përmbledhja ekzekutive dhe rekomandimet	4
1. Hyrje	6
2. Orientimet kyçe të programit qeveritar	7
3. Programi i qeverisjes dhe situata ekonomike dhe fiskale	10
4. Kostimi tentativ i disa elementeve të programit qeveritar dhe pasojat buxhetore	16
Aneks. Kostot e vlerësuara	18

## Përmbledhja ekzekutive dhe rekomandimet

---

Objektivi i këtij raporti të shkurtër është vlerësimi i kostove të programit të qeverisë kundrejt situatës aktuale ekonomike, buxhetit dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KAMSH). Ky raport kontribuon në përmirësimin e performancës dhe llogaridhënies në lidhje me arritjen e caqeve dhe objektivave. Raporti gjithashtu nënvizon shkurtimisht disa prej risqe që lidhen me fushat e intervenimeve dhe burimet e mundshme të financimit.

Ideja udhëheqëse e programit të qeverisë së re, siç u shpreh kryeministri në fjalimin e tij në Kuvend (më 17 maj 2021), është ndërtimi i një shoqërie ku secili të fitojë pjesën që meriton dhe të paguajë obligimet që i takojnë. Ai paraqet një qasje të re, e cila përputhet me atë që partia aktuale në pushtet e ka shpallur si filozofinë e saj politike. Programi dallohet për përfshirje dhe shpenzime më të mëdha të qeverisë kushtuar transfereve sociale, si dhe disa elemente të politikave që mund t'u atribuohen politikave të shtetit zhvillimor. Qeveria synon ta shqyrtojë dhe rishikojë programin në fillim të secilit vit fiskal. Kjo është e kuptueshme kur flitet për zbatimin e një programi me buxhete vjetore të konsoliduara të vendit; gjithsesi, për një dokument kaq të rëndësishëm, është e nevojshme të ketë të paktën një shqyrtim afatmesëm për trendet ekonomike si dhe për aspektet buxhetore dhe fiskale. Për këtë qëllim, dokumenti më i rëndësishëm do të duhej të ishte KAMSH-i. Qeveria e re ka përgatitur (përditësuar) KAMSH-in, i cili mbulon periudhën 2022-2024. Siç pohohet në këtë dokument, ai është përgatitur edhe në bazë të Programit Qeveritar 2021-2025. Megjithatë, ka ende mangësi serioze që duhen adresuar për një harmonizim më të mirë të programit të qeverisë, KAMSH-it dhe buxheteve vjetore.

Duket se shpenzimet e qeverisë gjatë katër viteve të ardhshme janë deri diku në kundërshtim me dinamikën dhe nivelin e vlerës së shtuar të re, përkatësisht BPV-së. Shpenzimet qeveritare kanë arritur pjesën më të lartë të BPV-së (mbi 32%) që do të ishte racionale dhe e përshtatshme për sa i përket barrës së arsyeshme për ekonominë dhe shoqërinë për koston e qeverisjes, dhe gjithashtu për sa i përket kapaciteteve absorbuese të institucioneve qeveritare dhe aftësisë së tyre që shpenzimet buxhetore t'i transformojnë me efektivitet dhe efikasitet në projekte dhe shërbime adekuate dhe me kosto-përfitime të pranueshme për shoqërinë dhe qytetarët. Një tjetër çështje shqetësuese është se borxhi publik do të dyfishohet deri në vitin 2024, dhe borxhi i jashtëm do të jetë më shumë se trefishi. Ky shqetësim lidhet më shumë me kapacitetet menaxheriale dhe absorbuese për përdorimin efektiv të këtyre fondeve sesa me barrën e përgjithshme të borxhit publik, e cila mbetet relativisht e ulët nëse matet si pjesë e BPV-së.

Kujdesi social dhe transferet tashmë thithin pjesën më të konsiderueshme të buxhetit, me vlerë prej rreth 19.6 %. Programi i qeverisë ka dhënë indikacione për disa vija të reja të shpenzimeve që do të përfshihen në këtë zarf, p.sh. shtesa për pushimin e lehonisë, ndihma për nënat e reja të papuna, shtesat e fëmijëve. Megjithatë, vëllimi i shpenzimeve pritet të mbetet i ngjashëm (pak më i ulët) në vitin 2024 krahasuar me vitin 2021. Përfshirja e vijave të reja të shpenzimeve do të ishte e mundur vetëm me ristrukturim dhe reduktim të disa vijave aktuale të shpenzimeve. Kjo është e nevojshme duke qenë se kjo kategori shpenzimesh buxhetore konsiderohet shumë e lartë për mundësitë buxhetore të vendit dhe nivelin e tij ekonomik dhe social të zhvillimit. Nga ana tjetër, shpenzimet qeveritare në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë mbeten jo adekuate në aspektin e proporcionit buxhetor; të ulëta në krahasim me rajonin dhe veçanërisht me nevojat për transformimin e këtyre sektorëve për t'u shërbyer më mirë nevojave të qytetarëve.

## REKOMANDIME

1. Qeveria, ministrinë dhe agjencinë e tjera buxhetore duhet të harmonizojnë programin e qeverisë, KAMSH-in dhe buxhetet vjetore, dhe të eliminojnë hendekët ekzistues, të vlerësojnë prioritetet dhe kostot për arritjen e tyre.
2. Rekomandojmë veçanërisht politika dhe forma të tjera të mbështetjes për rritjen e investimeve të sektorit privat, politika të ofertës për stimulimin e rritjes dhe konkurrueshmërisë së produkteve dhe shërbimeve vendase dhe nxitjen e rritjes ekonomike si parakusht kritik për stabilitetin makro-ekonomik dhe fiskal.
3. Rekomandojmë një analizë rigorozë për rritjen shumë të shpejtë të borxhit publik dhe menaxhimin e tij, për përdorimin efektiv të kredive dhe përshtatjen e këtyre prioritetëve për rritjen ekonomike dhe zhvillimin social, si dhe për kapacitetet absorbuese për ta përdorur dhe menaxhuar borxhin dhe kreditë.
4. Të ristrukturohen transferet sociale dhe subvencionet, të përshtaten tyre me prioritetet dhe mundësitë buxhetore, dhe të rritet efektshmëria e tyre;
5. Të ristrukturohen shpenzimet buxhetore dhe të rritet ndjeshëm pjesa e shpenzimeve buxhetore/qeveritare në shëndetësi dhe arsim.

# 1. Hyrje

---

Vlerësimi i planit të kostove të programit qeverisës është i një rëndësie tepër të madhe për përmirësimin e performancës dhe llogaridhënies në arritjen e objektivave dhe objektivave të këtij programi. Vlerësimi i kostove mund të jetë një hap crucial i procesit të formulimit të programit qeveritar, i cili u lejon vendimmarrësve të marrin në konsideratë shkallën në të cilën objektivat e politikave dhe orientimet strategjike janë të realizueshme dhe të përballueshme. Procesi i përcaktimit të kostove të një programi duhet të konsiderohet si pjesë esenciale e procesit të planifikimit dhe jo të ndërmerret pasi plani i përgjithshëm të jetë përfunduar dhe paraqitur si dokument i finalizuar.

Për ta plotësuar këtë hendek, fokusi i këtij raporti është në një vlerësim ex-ante të kostove të lidhura me zonat e përzgjedhura për intervenime dhe burimet e mundshme të financimit siç propozohen nga programi i qeverisë. Ky vlerësim do të përqipet të vlerësojë në mënyrë kritike supozimet dhe risqet që lidhen me programin e qeverisë. Duke e bërë këtë, do të informohet publiku i gjerë dhe do të nisë një debat i informuar që në fund do të çonte në monitorim, transparencë dhe llogaridhënie më të mirë. Vlerësimet e kostove janë të nevojshme për programet qeveritare për shumë arsye: për të mbështetur vendimet për financimin e një projekti kundrejt një tjetri, për të zhvilluar një buxhet vjetor, për të vlerësuar kërkesat për burime në pikat kryesore, si dhe për të zhvilluar bazat për matjen e performancës. Për më tepër, të paturit e një vlerësimi real të kostove të parashikuara siguron alokim efektiv të burimeve dhe rrit probabilitetin e suksesit të një programi.

Zhvillimi i vlerësimeve të besueshme të kostove nuk është një praktikë tradicionale në Kosovë. Zakonisht qeverive u ka munguar vullneti për të ofruar vlerësime të besueshme të kostove, të cilat do të përbënin një burim thelbësor informacioni për përpjekjet për të kërkuar llogaridhënie. Gjithashtu, vlerësimi i kostove është sfidues pasi kërkon kohë dhe burime. Programet e qeverisë në mënyrë karakteristike bazohen në supozime joreale, veçanërisht në lidhje me kompleksitetin ose vështirësinë e futjes së politikave të reja. Gjithashtu, programet bazohen në një kulturë optimizmi, e cila, përveç disa meritave, mund të çojë edhe në mbivlerësimin e aftësisë së qeverisë që t'i realizojë detyrat përkatëse. Mund të rezultojë edhe në nënvlerësim të risqeve, çka mund të çojë në zhvillimin e vlerësimeve joreale të kostove dhe afateve.

Për të zbutur siç duhet riskun që vjen nga ky optimizëm, është thelbësore të kemi një pamje të pavarur të programit. Teksa ky funksion mund të kryhet edhe nga organizata të jashtme si Riinvest, është prapëseprapë e rëndësishme që qeveria të jetë e gatshme t'i adresojë dhe t'i kuptojë risqet me të cilat përballlet programi i saj. Të paturit e një pikëpamjeje të pavarur për programin mund të ndihmojë në zbulimin e veprimeve që mundën potencialisht ta kufizojnë aftësinë e qeverisë për të pasur sukses.

Ky raport është përgatitur në bazë të të dhënave që mund të kuantifikohen nga programi i qeverisë, të shtuara nga të dhënat nga burimet zyrtare, kryesisht Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Në disa raste, autorët kanë bërë supozime të caktuara për të llogaritur informacionin e munguar ose për të ofruar një skenar. Të gjitha ato raste janë etiketuar siç duhet. Raporti është organizuar si më poshtë: seksioni 1 paraqet orientimet kryesore të programit qeveritar. Seksioni i dytë jep një pasqyrë të programit të qeverisë kundrejt situatës fiskale të vendit. Seksioni i tretë ofron një përcaktim paraprak të kostove të disa prej elementeve të programit të qeverisë dhe të implikimeve buxhetore. Gjetjet kryesore dhe rekomandimet e politikave janë paraqitur në mënyrë koncize në përmbledhjen ekzekutive. Riinvest dëshiron t'i falënderojë të gjitha palët e përfshira në përgatitjen e këtij raporti për kontributin e tyre, ndërkohë që merr përgjegjësinë e vetme për gjetjet dhe konkluzionet e raportit.

## 2. Orientimet kyçe të programit qeveritar

Qeveria e re, e kryesuar nga kryeministri Albin Kurti, e ka prezantuar programin e saj qeverisë (2021-2025) më 17 maj 2021. Në fjalën e tij prezantuese, Kryeministri u shpreh se prioriteti kryesor për qeverinë është menaxhimi i situatës së krijuar nga pandemia COVID-19. Sipas kryeministrit, në 55 ditët e para kanë arritur të sigurojnë 74,100 vaksina, ndërsa deri në fund të majit do të kenë edhe 142,530 vaksina të tjera.

Kryeministri u shpreh se qeveria e tij planifikon të ndërtojë një shoqëri ku secili të fitojë pjesën që meriton dhe të paguajë obligimin që i takon. Qeveria aspiron të ndërtojë një shoqëri të barabartë me mundësi të barabarta për të gjithë. Një shoqëri që kujdeset për më të dobëtit dhe ata që fitojnë më pak. Andaj, ata kanë zhvilluar një program që rrit pagën minimale dhe rrit pragun e pagave të patatueshme. Sipas kryeministrit, në Kosovë askush që punon 8 orë në ditë nuk duhet të marrë më pak se 10 euro në ditë dhe askush nuk duhet të tatóhet për mbijetesë.

Lidhur me punësimin, kryeministri u shpreh se qeveria ka hartuar një skemë punësimi të garantuar për të rinjtë ku qeveria do të paguajë pagën minimale për një vit për çdo të ri që punësohet për herë të parë. Qeveria planifikon edhe aktivizimin e masave për punësimin e grave dhe përmirësimin e likuiditetit për bizneset në pronësi dhe të udhëhequra nga gratë, si dhe masa për të nxitur vetëpunësimin e grave të reja nga zonat rurale, ku planifikohen 40 ndërmarrje të udhëhequra nga gratë.

Qeveria planifikon të fillojë me reformën në sundimin e ligjit dhe drejtësi. Procesi i vetting-ut do të vazhdojë aty ku u ndërpre në pranverën e vitit 2020. Këtij procesi do t'i nënshtrohen gjyqtarët, prokurorët, inspektorët dhe zyrtarët e lartë të policisë dhe inteligjencës. Kodi i Procedurës Penale do të finalizohet. Pasuria e paligjshme dhe e pajustificueshme do të hetohet dhe konfiskohet. Do të krijohen Gjykatat Ekonomike, Administrative dhe të Punës. Për drejtësinë e vonuar kundër krimeve të Serbisë në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, qeveria planifikon të themelojë Institutin për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë dhe do të paraqesë padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë për gjenocidin e Serbisë në Kosovë.

Pabarazia ekonomike do të tentohet të zbutet përmes skemave sociale dhe zhvillimit ekonomik. Kryeministri tha se së shpejti qeveria do të nisë me një skemë për ndarjes së shtesës për fëmijë dhe të lehonisë. Skema parashikon ndarjen e 20 eurove në muaj për fëmijët deri në 2 vjeç dhe 10 euro në muaj për fëmijët nga 2 deri në 16 vjeç. Qeveria gjithashtu planifikon ta ndryshojë pushimin e lehonisë dhe të fusë pushimin e atësisë, në mënyrë që të dy prindërit të mbajnë barrën e rritjes së një fëmije të porsalindur. Për nënat e reja dhe të papuna do të paguhet paga minimale prej 250 euro në gjashtë muajt e parë pas lindjes. Për të moshuarit, planifikohet të ndërtohen pesë shtëpi të reja që do të ofrojnë shërbime përkujdesjeje. Ndërkohë, përmes programeve "120 x 120" dhe "150 x 150" qeveria planifikon t'u ofrojë çifteve të reja banesa me këste mujore vetëm 120 ose 150 euro në muaj, për një periudhë jo më shumë se 120 ose 150 muaj.

Sa i përket zhvillimit ekonomik, kryeministri është shprehur se ai dhe kabineti i tij synojnë rimëkëmbjen ekonomike pas pandemisë. Investimet parashikohen të orientohen drejt sektorit të arsimit, trajnimit, digjitalizimit, investimeve në kapitalin njerëzor, energjisë, infrastrukturës dhe promovimit

të prodhimit lokal, duke përfshirë një koncept të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe inovativ. Për ta arritur këtë, qeveria planifikon të bëjë reforma në prokurimin publik dhe administratën publike. Pjesë të TC 'Kosova A' do të dekomisionohen, kurse investimet në TC 'Kosova B' do të bëhen në atë mënyrë që të mos rrezikohet siguria e furnizimit me energji elektrike gjatë tranzicionit. Për të siguruar që kapitali i diasporës të kanalizohet në investime që krijojnë vende pune, qeveria që nga viti i parë do të emetojë bono thesari kushtuar diasporës.

Kryeministri tha se planifikohet themelimi i Fondit Sovran, i cili do të marrë pronësinë e asetëve strategjike të Republikës së Kosovës. Fondi do të krijohet për të valorizuar asetet strategjike, për të mundësuar investime të huaja, qasje në tregjet e huaja të kapitalit, dhe për të tërhequr investime të huaja për të rritur vlerën e Trepçës, KEK-ut, Telekomit dhe Postës. Duke përdorur grantin e katërt për komunat, do të financohen projekte infrastrukturore të cilat gjenerojnë jo vetëm vende të reja pune, por edhe ndërtojnë infrastrukturë kritike për rivitalizimin dhe urbanizimin e komunave.

Ndërmarrësve u premtohet se do t'u sigurohet qasje në financa për të përballuar rritjen e prodhimit. Kryeministri ka premtuar gjithashtu krijimin e një Banke Zhvillimore, e cila do të shërbejë si një mekanizëm për mbështetjen e sektorit privat dhe nxitjen e investimeve. Më tej, qeveria planifikon të krijojë Fondin për Ndërmarrësit e Rinj dhe do të ndajë 2000 grante çdo vit për ndërmarrësit e rinj. Agjencia Kosovare e Privatizimit do të shuhet dhe do të kalojë nën një agjenci në kuadër të qeverisë, si dhe do të krijohet Agjencia Zhvillimore për të udhëhequr politikën zhvillimore ndërmjet ministrive dhe agjencive të pavarura.

Politikat fiskale janë planifikuar të reformohen. Kjo është planifikuar të bëhet përmes aplikimit të politikave të reja, të cilat do të përfshijnë analizën e sistemit tatimor, shqyrtimin e sistemit tatimor për bizneset e vogla dhe të mesme, ndryshimin e formularit të deklarimit të tatimit në të hyrat personale, dhe vendosjen e detyrimit për deklarimin vjetor të tatimit në të hyrat personale. Kjo do të ndihmojë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në përdorimin e financave publike. Për të luftuar ekonominë informale dhe për të mbrojtur të drejtat e punonjësve, qeveria planifikon të rrisë numrin e inspektorëve dhe të forcojë kapacitetet hetuese dhe inteligjente të inspektorateve ekzistues.

Qeveria ka planifikuar gjithashtu të reformojë sektorin e Arsimit. Kurrikulat e arsimit të hershëm/ fillor do të rishikohen në mënyrë që të orientohen drejt aftësive vetë-rregulluese të fëmijëve, dhe qeveria do të ofrojë mbështetje të vazhdueshme profesionale për mësimmshënësist që të zbatohen kurrikulat e reja dhe të rikthehet vëmendja tek mësimmshënësist. Qeveria planifikon të investojë në 160 kopshte dhe për përshtatjen e hapësirave në shkolla. Në këtë mënyrë, planifikohet të rritet përfshirja në edukimin e fëmijërisë së hershme nga 7% në 24% për fëmijët e moshës 0-5 vjeç, dhe nga 38% në 64% për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Qeveria planifikon punësimin e 400 pedagogëve, psikologëve dhe punëtorëve socialë në kuadër të konsolidimit të shërbimit psiko-pedagogjik në shkolla. Më tej, planifikohet të bëhen 500 vlerësime të jashtme të shkollave për të siguruar një vlerësim të drejtë dhe cilësor. Qeveria planifikon trajnimin e 5000 mësimmshënësve në vit dhe licencimin e 9000 mësimmshënësve bazuar në vlerësimin e performancës për të siguruar që nxënësist të marrin arsimin që meritojnë. Planifikohet investime në biblioteka, ofrimi i bursave për 1000 vajza që zgjedhin të studiojnë shkenca, teknologji dhe inxhinieri. Arsimi duhet të jetë falas. Në universitetet publike nuk do të paguhet asnjë tarifë për semestrin. Angazhimi i studentëve është planifikuar të stimulohet përmes praktikave në të gjitha institucionet publike.

Parashikohet të reformohet edhe sistemi shëndetësor. Është planifikuar të sigurohet infrastrukturë moderne, kushte pune për mjekët, barna të mjaftueshme për pacientët. Qasja e barabartë në shërbimet shëndetësore dhe sigurimet shëndetësore është premtuar se do të garantohet për të gjithë



qytetarët. Numri i inspektorëve shëndetësorë dhe farmaceutikë pritet të rritet me 30, ndërsa për 2000 qytetarë do të caktohet një mjek i familjes.

Në sektorin e bujqësisë, fermerët do të mbrohen dhe ndihmohen. Kryeministri deklaroi se qeveria e tij do të vendosë çmime minimale për një sërë produktesh bujqësore strategjike për të garantuar stabilitetin e tregut. Do të jepen grante dhe subvencione dhe investimet në infrastrukturë do të ndihmojnë në kthimin e bujqësisë në një sektor fitimprurës që siguron një jetë dinjitoze për fermerët. Do të përfundohen projektet infrastrukturore që janë duke u realizuar aktualisht dhe do të fillohen të reja. Qeveria planifikon të përfundojë segmentin e autostradës Besi-Merdare dhe autostradës Prishtinë-Gjilan, të zgjerojë segmentin ekzistues të rrjetit rrugor Prishtinë-Mitrovicë dhe autostradën Kijev-Zahaq. Qeveria planifikon ndërtimin e unazës së jashtme të Prishtinës, zgjerimin e rrugës nacionale Istog-Pejë-Deçan-Gjakovë-Prizren, duke përfshirë edhe rrugët unazore, rehabilitimin e rrugës nacionale Qafë Duhël-Shtime-Ferizaj, e cila lidhet me magjistralen Prishtinë-Shkup, si dhe ndërtimin e rrugëve kufitare Deçan-Plavë, Prizren-Tetovë dhe Gjilan-Kumanovë.

Politika e jashtme shihet si një shtyllë thelbësore e subjektivitetit ndërkombëtar por edhe e shtet-ndërtimit demokratik. Kryeministri u shpreh se politika e jashtme duhet të na mbrojë nga armiqtë dhe të thellojë bashkëpunimin tonë me miqtë tanë, ndaj orientimet tona për integrim në NATO dhe në Bashkimin Evropian janë të qarta. Aleanca me Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të thellohet bazuar në vlerat e përbashkëta dhe Forca e Sigurisë do të vazhdojë të forcojë kapacitetin e saj për t'u bërë një forcë e denjë për të ruajtur sigurinë dhe për të mbrojtur integritetin territorial. Anëtarësimi në BE mbetet një prioritet që nuk duhet zëvendësuar, por gjithashtu një proces që nuk duhet të ngadalësohet. Zgjidhja e çështjeve të hapura me Serbinë duhet të bëhet përmes dialogut parimor. Kosova e njeh dialogun me Serbinë vetëm nëse merr pjesë si palë e barabartë dhe dialogu do të përdoret për zgjidhjen e çështjeve të pazgjidhura, siç janë zbardhja e fatit të personave të pagjetur, borxhet dhe dëmet e luftës, reparacionet dhe suksesioni.

Kultura dhe sporti parashikohet të zhvillohen dhe të mbështeten. Qeveria synon ta bëjë Kosovën shtetin që organizon gara dhe kampionate, festivale dhe koncerte, të cilat e vendosin vendin tonë në hartën botërore dhe në të njëjtën kohë sjellin rritje ekonomike për mbarë shoqërinë kosovare. Më tej, qeveria planifikon të zgjerojë hapësirat kulturore, të ndërtojë Teatrin e Operës dhe Baletit, Teatrin e ri Kombëtar, Muzeun e Artit Bashkëkohor dhe Rrjetin e Kinemave të Kosovës. Qeveria planifikon të përmirësojë infrastrukturën sportive dhe të investojë në sportet elitare në mënyrë që Kosova të ketë rezultate sa më të larta në arenën ndërkombëtare.

Marrë parasysh kapacitetet e kufizuara buxhetore, qeveria duhet të rrisë efikasitetin dhe efektshmërinë e intervenimeve të saj duke përdorur një qasje kosto-përfitim për të përcaktuar prioritetet. Për ta bërë këtë, është e nevojshme të bëhet një vlerësim ex-ante i planit të kostove të masave të qeverisë.

### 3. Programi i qeverisjes dhe situata ekonomike dhe fiskale

---

Programi i Qeverisë 2021-2025 paraqet një qasje të re, e cila përputhet me atë që partia aktuale në pushtet e ka shpallur si filozofinë e saj politike. Programi dallohet për përfshirje dhe shpenzime më të mëdha të qeverisë kushtuar transfereve sociale, si dhe disa elemente të politikave që mund t'u atribuohen politikave të shtetit zhvillimor. Gjithashtu, fokusi është në forcimin e sundimit të ligjit, përmirësimin e mundësive për arsim dhe punësim, dhe gjithashtu përballjen me pasojat e Covid-19. Qeveria synon ta shqyrtojë dhe rishikojë programin në fillim të secilit vit fiskal. Kjo është e kuptueshme kur flitet për zbatimin e një programi me buxhete vjetore të konsoliduara të vendit, gjithsesi, për një dokument kaq të rëndësishëm, është e nevojshme të ketë të paktën një shqyrtim afatmesëm për trendet ekonomike si dhe për aspektet buxhetore dhe fiskale. Për këtë qëllim, dokumenti më i rëndësishëm do të duhej të ishte KAMSH-i. Qeveria e re e ka përgatitur (përditësuar) këtë dokument për periudhën 2022-2024. Siç pohohet në këtë dokument, ai është përgatitur edhe në bazë të Programit Qeveritar 2021-2025.

Bazuar në analizat tona, sfidat kryesore që e presin qeverinë e re janë (1) si mund të akomodohet gjithçka me mundësitë ekzistuese buxhetore dhe (2) si të inkorporohen instrumentet dhe politikat e shtetit zhvillimor, përkatësisht Fondit Sovran dhe Bankës Zhvillimore, në kuadër të strukturës aktuale institucionale, e cila bazohet në një qasje të ndryshme lidhur me rolin që duhet të kenë institucionet shtetërore në çështjet e biznesit.

Vetë Programi Qeveritar 2021-2025 nuk përmban balancat makroekonomike nacionale dhe treguesit që janë të nevojshëm për të vlerësuar nëse ky program ka hapësirë adekuate në këto balanca dhe dinamikat e pritshme pas Covid-19 lidhur me rritjen ekonomike, të hyrat buxhetore dhe përshtatshmërinë e tyre për të mbështetur shpenzimet buxhetore që lidhen me politikat e qeverisë. Mirëpo, thuhet se do të realizohet përmes buxheteve vjetore që pritet të ndjekin Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KAMSH), e përditësuar së fundmi për periudhën 2022-2024. Duke qenë se ky është dokumenti më i rëndësishëm që duhet të drejtojë politikat qeveritare, vlerësimi ynë i barrës së kostos së Programit të Qeverisë do të bazohet kryesisht në këtë dokument. Tabela (1) më poshtë ilustron dinamikën e komponentëve kyç të burimeve të financimit buxhetor gjatë periudhës deri në vitin 2024, krahasuar me vitin 2020.

**Tabela 1: Rritja e BPV-së dhe komponentët kyç të buxhetit në %**

	2024/ 2020
BPV	+18%
Gjithsej të ardhura buxhetore	+34%
Gjithsej shpenzime buxhetore	+22.2%
Të ardhura tatimore	+34%
Të ardhura jo tatimore	+37%
Borxh publik	+137%
Borxhi i brendshëm	+60%
I jashtëm (borxhi i jashtëm)	+211%

Burimi: Llogaritur në bazë të KAMSH-it, MFPT, prill 2021

Bazuar në këto parashikime, rritja ekonomike pritet të kthehet në modelin e saj historik të periudhës para COVID-19 me rreth 4%-4.5%, pas rimëkëmbjes gjatë vitit 2021 me rritje prej 5%, e barabartë me vlerën e shtuar në vend në nivelin e vitit 2019, rritje kjo më e mirë sesa pritej dhe pak më optimiste se parashikimet e BB-së dhe FMN-së për rritje prej 4% dhe 4.5% përkatësisht. Këto ritme të rritjes mund të konsiderohen mjaft realiste/konservatore. Por megjithatë, ato janë nën nevojat e ekonomisë kosovare për t'i trajtuar me sukses disbalancat makroekonomike, kryesisht papunësinë e lartë dhe deficitin e lartë të tregtisë së jashtme. Instituti Riinvest ka avokuar vazhdimisht për politika aktive ekonomike dhe industriale në linjën e politikave nga ana e ofertës për të garantuar rritje të qëndrueshme ekonomike afatgjatë. Programi i qeverisë ka disa tregues për përfshirje më të madhe të qeverisë në mbështetjen e ndërmarrësve dhe bizneseve, por gjithsesi këto orientime nuk janë mjaft të qarta për sa i përket konsistencës së tyre me rolin e institucioneve shtetërore dhe përfshirjes për një ekonomi të tregut të hapur.

Duket se shpenzimet e qeverisë gjatë katër viteve të ardhshme janë deri diku në kundërshtim me dinamikën dhe nivelin e vlerës së shtuar të re, përkatësisht BPV-së. Shpenzimet qeveritare kanë arritur pjesën më të lartë të BPV që do të ishte racionale dhe e përshtatshme për sa i përket barrës së arsyeshme për ekonominë dhe shoqërinë për koston e qeverisjes, dhe gjithashtu për sa i përket kapaciteteve absorbuese të institucioneve qeveritare dhe aftësisë së tyre që shpenzimet buxhetore t'i transformojnë me efektivitet dhe efikasitet në projekte dhe shërbime adekuate dhe me kosto-përfitime të pranueshme për shoqërinë dhe qytetarët. Përvoja e ekonomive në zhvillim do të këshillonte që pjesa mbi 30-32 % e buxhetit ndaj BPV-së nuk është e shëndetshme për një ekonomi. Në vijim, Tabela 2 më poshtë tregon se nuk ka më hapësirë racionale për ta ngarkuar BPV-në me rritjen e shpenzimeve buxhetore. Krejt e kundërta. Fokusi duhet të jetë tek përshpejtimi i rritjes ekonomike, rritja e nivelit të BPV-së dhe bërja e qeverisë më pak të kushtueshme për sektorin privat. Dhe kjo është fusha që duhet sqaruar dhe trajtuar nga qeveria e re.

**TABELA 2: Shpenzimet qeveritare ndaj BPV-së (milion euro)**

	2020	2021	2024
Shpenzimet qeveritare	2,235	2,454	2,708
BPV	6,803	7,243	8,458
Shpenzimet qeveritare / BPV (%)	32.8	33.8	32.0

Burimi: Llogaritur në bazë të MFPT, KAMSH, prill 2021

Është e qartë se brenda këtyre parashikimeve të rritjes ekonomike, rritja e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore nga qeveria e re duhet të mbështetet në mbledhjen më të mirë të të ardhurave buxhetore, uljen e nivelit të informalitetit, rritjen e mbledhjes së tatimeve (të hyrat personale), si dhe nga rritja e borxhit publik që do të jetë dyfishuar gjatë kësaj periudhe. Pas rritjes dinamike të borxhit të brendshëm publik gjatë pesë viteve të fundit, deri në vitin 2024 ai do të rritet për 60% krahasuar me vitin 2020. Veçanërisht duhet theksuar dhe analizuar fakti se borxhi i jashtëm brenda këtyre katër viteve do të rritet pothuajse në mënyrë eksponenciale; do të jetë më shumë se trefishi. Edhe pse për sa i përket barrës së përgjithshme të borxhit publik, situata nuk është për t'u alarmuar, sidomos kur shikohet raporti i borxhit publik ndaj BPV-së. Pas rritjes shumë dinamike gjatë pesë viteve të fundit, veçanërisht të borxhit të brendshëm, ai arriti në 22.3% (2020) dhe pritet që pjesa e tij ndaj BPV-së të rritet në rreth 38% (2024). Është ende më i ulët se në shumicën e vendeve të tjera, por hap sërish pyetje shumë serioze në lidhje me kapacitetet absorbuese të agjencive qeveritare (ministritë dhe të tjera) dhe PEO-ve për t'i kanalizuar huamarrjen dhe kreditë në projekte dhe shërbime me kosto-përfitime dhe norma të përshtatshme të kthimit ekonomik. Problemet në këtë fushë janë serioze në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të projekteve, duke filluar nga studimet sektoriale, studimet e para-fizibilitetit dhe fizibilitetit, përgatitja dhe planifikimi i projekteve, vlerësimi, prokurimi, kontraktimi dhe zbatimi. E gjithë kjo shoqërohet me mangësi dhe pasoja serioze në vonimin e zbatimit të projekteve, rritje të kostove të financimit dhe përkeqësim të rëndë të raportit kosto-përfitim të projekteve. Përqindja relativisht e ulët e borxhit publik ndaj BPV-së nuk duhet ta zvogëlojë rigrozitetin e analizave të fizibilitetit të projekteve, dhe duhet gjithashtu të vlerësohen në mënyrë adekuate aftësitë e agjencive qeveritare për t'i menaxhuar projektet dhe kreditë dhe për të siguruar kthime të përshtatshme për t'i shlyer kreditë sipas planeve të tyre të maturimit. Huamarrja joefikase dhe kreditë që nuk arrijnë të sigurojnë fizibilitet dhe raport të përshtatshëm kosto-përfitim, do të kenë pasoja negative në stabilitetin makroekonomik dhe fiskal të vendit dhe në cilësinë e jetës së gjeneratave të ardhshme.

**Tabela 3: Destinimet kyçe buxhetore**

	2021	%	2024	%
<b>Buxheti i përgjithshëm/ shpenzime buxhetore</b>	2,454	100	2,708	100
<b>Paga</b>	639	26.0	663	24.5
<b>Mallra dhe shërbime</b>	363	14.8	365	13.5
<b>Subvencione dhe transfere</b>	786	32.0	771	28.5
<b>Shpenzime kapitale / investim publik</b>	626	25.5	849	31.3
<b>Balanca e Buxhetit / Deficiti</b>	-566	23%	- 399	14.7

Duke parë destinimet kyçe buxhetore të dizajnuara në KAMSH (tabela 3) mund të vërehet se ka një orientim për të përmirësuar marrëdhëniet aktuale të deformuara në strukturën e brendshme, që pjesërisht është edhe pasojë e intervenimeve kundër COVID-19. Pagat do të kenë pjesë më të ulët në krahasim me periudhën para COVID-19. Mbeten të hapura çështjet e Ligjit për pagat i cili u pezullua nga Gjykata Kushtetuese. Gjithashtu, ka disa sektorë që ankohen për paga të ulëta dhe kjo është veçanërisht e vërtetë për mjekët specialistë në Qendrën Klinike Universitare dhe spitale të tjera, që konsiderohen se janë nën nivelin që mund të siguronte motivimin adekuat të stafit kyç mjekësor.

Shpenzimet buxhetore në Kosovë janë të mbingarkuar nga subvencionet dhe transferet, të cilat u rritën me intervenimet në lidhje me COVID-19. Dhe ky mbetet si problem edhe me Programin e Qeverisë së Re. Përqindja e kësaj kategorie në buxhetin e përgjithshëm tregon se qeveria duhet t'i rishikojë politikën në lidhje me transferet. Transferet sociale duhet të auditohen për sa i përket përshtatshmërisë së tyre me kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës, ndërsa transferet e ministrive të ndryshme për projekte dhe shërbime duhet të vlerësohen në mënyrë kritike. Mbështetja me subvencione për sektorin privat, ndërmarrësit, fermerët, OJQ-të, sportet dhe artistët, duhet të avancohet ndjeshëm dhe të bazohet në objektiva të qarta dhe në rezultatet e pritura. Kjo çështje sërish lidhet edhe me kapacitetet absorbuese të ministrive përkatëse për ta menaxhuar në mënyrë adekuate procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të destinimeve dhe projekteve të mbështetura veçanërisht me subvencione. Ndikimet tjera negative – përkatësia politike, nepotizmi, korrupsioni dhe forma të tjera të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, mund t'i vënë në pikëpyetje serioze efektet reale të këtyre transfereve. Fakti që ato kanë arritur nivelin e shpenzimeve kapitale dhe janë bërë kategoria më e rëndë në kuadër të shpenzimeve buxhetore, kërkon angazhim serioz nga qeveria për ta vlerësuar në mënyrë kritike situatën dhe për të ndërmarrë politika dhe masa për rritjen e efekteve pozitive të transfereve dhe subvencioneve qeveritare.

Probleme të veçanta paraqiten nga fakti se gati 1/4 e shpenzimeve buxhetore (2021) duhet të shërbehet nga burime të jashtme, kryesisht kredi të huaja. Kjo pritjet/parashikohet të redukto-

het në 1/6 e shpenzimeve buxhetore deri në vitin 2024, dhe ky mund të jetë drejtimi i duhur. Por, nga ana tjetër, në kushtet e rritjes thuajse eksponenciale të borxhit të jashtëm, e gjithë çështja duhet të rishikohet dhe të analizohet seriozisht. Lidhur me këtë deficit të lartë buxhetor gjatë viteve 2020 dhe 2021 si pasojë e COVID-19 (-5.3 dhe -4.7% e BPV-së), pritet që të ulet gradualisht dhe në vitin 2023 të arrijë cakun prej 2% të BPV-së. Kjo mbështetet edhe me uljen e rezervës së kontingjencës bankare nga 3.3% në rreth 2% të BPV-së gjatë kësaj periudhe.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i politikave buxhetore mund të analizohet nëpërmjet shpenzimeve buxhetore sektoriale. Tabela 4 më poshtë jep disa indikacione për këtë qëllim.

#### Destinimi sektorial i shpenzimeve buxhetore (milion euro)

Sektorët				% e bux- hetit total	2024/2021, % e ndryshimit
	2020	2021	2024	2024	
Gjithsej shpenzime buxhetore	2,234	2,454	2,709	100%	10.4%
Ekonomia	362	359	420	15.50%	17.0%
Mbrojtja	59	67	133	4.91%	98.5%
Sundimi i ligjit	223	235	248	9.15%	5.5%
Mjedisi	32	34	93	3.43%	173.5%
Strehimi	6	8	7	0.26%	-12.5%
Shëndetësia	185	209	210	7.75%	0.5%
Arsimi	79	97	99	3.65%	2.1%
Kultura, sporti dhe feja	39	51	52	1.92%	2.0%
Kujdesi social	555	551	530	19.56%	-3.8%
Qeverisja qendrore	122	296	227	8.38%	-23.3%
Komunat: grantet e qeverisë	463	440	503	18.57%	14.3%
Tjetër	109	107	187	6.90%	74.8%

Në bazë të KAMSH-it për periudhën 2022-2024, i cili është miratuar nga qeveria si dokument që është dashur të përdoret si bazë për përvijimin e programit qeveritar 2021-2024, është e vështirë të shihen prioritetet e qeverisë. Për sa i përket dinamikës së rritjes së shpenzimeve buxhetore, prioritet i është dhënë mjedisit, mbrojtjes, ekonomisë dhe granteve nga buxheti qendror dedikuar komunave. Për sa i përket pjesës në shpenzimet totale buxhetore, shohim peshë më të madhe të kujdesit social, ekonomisë dhe granteve për komunat, gjyqësorin dhe sundimin e ligjit.

Duke ndjekur orientimin e programit qeveritar, mbeten për t'u analizuar posaçërisht shpenzimet e qeverisë në shëndetësi dhe arsim. Shpenzimet vjetore të qeverisë në shëndetësi (duke përfshirë grantin për komunat) pritet të arrijnë në rreth 279 milionë euro (2024), që është rreth 3.3% e BPV-së dhe vlerë shumë e ulët edhe për sa i përket nivelit të shpenzimeve qeveritare në BB6. Kjo kërkon një rishqyrtim serioz duke synuar të paktën dyfishimin e shpenzimeve të qeverisë në këtë sektor. E njëjta gjë vlen edhe kur bëhet fjalë për shpenzimet buxhetore në arsim, të cilat arrijnë gjithashtu vetëm 3.8% duke përfshirë edhe punën për hulumtime. Përmirësimet në këta sektorë janë me rëndësi kritike për rritjen e kapaciteteve absorbuese të shoqërisë për zhvillim, dhe gjithashtu për zbatimin e politikave të anës së ofertës me qëllim të rritjes së produkteve dhe shërbimeve konkurruese vendore për Kosovën dhe tregun e jashtëm. Shpenzimet në të dy sektorët, sipas këtij dokumenti, nuk do të jenë prioritet. Kjo do të thotë se mbetet hapësirë shumë e ngushtë për zbatimin e disa prej risive të propozuara me programin e qeverisë, p.sh. bursa, fondi për hulumtime, trajnimet e mësimdhënësve, punësimi i pedagogëve, investimi në arsimin parafillor dhe vlerësuesit e jashtëm, pastaj rritja e numrit të mjekëve të familjes dhe gjithashtu përmirësimi i nivelit të pagave të mjekëve specialistë me përvojë dhe furnizimi me pajisjet e nevojshme, veçanërisht për shërbimet e sofistikuar të shëndetësisë terciare.

Kujdesi social dhe transferet tashmë thithin pjesën më të madhe të buxhetit me vlerë prej rreth 19.6 %. Programi i qeverisë ka dhënë indikacione për disa vija të reja the shpenzimeve që do të përfshihen në këtë zarf, p.sh. shtesa për pushimin e lehonisë, shtesa për nënat e reja papuna, shtesat e fëmijëve. Megjithatë vëllimi i shpenzimeve pritet të mbetet i ngjashëm (pak më i ulët) në vitin 2024 krahasuar me vitin 2021. Përfshirja e vijave të reja do të ishte e mundur vetëm me ristrukturim dhe reduktim të një pjese të shpenzimeve rrjedhëse, gjë që është e nevojshme duke qenë se kjo kategori shpenzimesh buxhetore konsiderohet shumë e lartë për mundësitë buxhetore të vendit dhe nivelin e tij ekonomik dhe social të zhvillimit.

Komunat do të gëzojnë rritje të burimeve buxhetore të granteve – grant i ri për infrastrukturën që duket të jetë zgjidhje e mirë pasi mund të reduktojë investimet në infrastrukturën lokale nga niveli qendror dhe të sigurojë më shumë kritere objektiviteti dhe hapësirë për komunat për të investuar në përmirësimin e infrastrukturës së tyre lokale.

Disa risi të tjera të programit të qeverisë në fushën e banimit, 2000 grante për ndërmarrësit e rinj, çmimi minimal i garantuar për produktet bujqësore dhe subvencionet, investimet në rrugë dhe hekurudha me shumë gjasa do të duhet të presin ristrukturimin e shpenzimeve në ministritë që kanë të bëjnë me "Ekonominë" (MTI, MFPT, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Infrastrukturës dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë)

## 4. Kostimi tentativ i disa elementeve të programit qeveritar dhe pasojat buxhetore

Siç u theksua, shumica e propozimeve që kanë të bëjnë me masat dhe politikat e reja të lansuara, veçanërisht në fushën e transfereve sociale, ende nuk janë të ndërlidhura me shpenzimet buxhetore të parapara me KAMSH-in 2022-2024. Në fakt, për këto kategori programi i qeverisë nuk ka ende një vlerësim për koston e tyre. Tashmë theksohet se buxheti vjetor i konsoliduar i Kosovës duhet të sigurojë zbatimin e këtij programi. Kjo është e saktë, por qeverisë i duhet të paktën një horizont kohor afatmesëm për të akomoduar, dhe eventualisht për t'i rregulluar, të gjitha këto elemente të reja me strukturën aktuale të shpenzimeve buxhetore. Shkurtime dhe strukturimi i menjëhershëm do të jetë shumë i vështirë dhe në disa raste pothuajse i pamundur.

Tabela 5 më poshtë paraqet kostimin tentativ të elementeve – propozimeve, politikave dhe masave që kanë ndikim të rëndësishëm buxhetor. Autorët e këtij Raporti janë në dijeni të informacionit të kufizuar të të dhënave për vlerësimin e kostove për disa nga masat e programeve qeveritare. Megjithatë, bazuar në të dhënat demografike dhe të tjera në publikimet e ASK-së dhe në nivelin e intervenimit të treguar në program, ne kemi ofruar disa kosto indikative, vetëm për qëllime analitike për të ilustruar nevojën për t'i testuar të gjitha këto kategori të reja të shpenzimeve buxhetore në aspektin e strukturës së tyre dhe dinamikës me situatën aktuale.

**Tabela 5: Kostimi tentativ i disa kostove shtesë buxhetore të disa elementeve të programit qeveritar**

Përshkrimi	Kosto indikative	Shënime
Shtesa për lehoninë dhe fëmijë deri 2 vjeç	10,694,160	
Shtesa për lehoninë dhe fëmijë 2-16 vjeç	62,707,608	
Skema për gratë e papuna	19,500,000	
Rritja e pagës minimale	37,000,000	
Skemat e punësimit	22,000,000	
Fondi për ndërmarrësit e rinj	20,000,000	
Parashkollor – Kopshte fëmijësh	18,750,000	
Bursa për vajza	1,200,000	
Pedagogë të rinj dhe vlerësues të jashtëm	8,000,000	
<b>Gjithsej</b>	<b>259,851,768</b>	

(Vlerësim indikativ i autorëve, bazuar në të dhënat e ASK-së dhe vlerësime të tjera)



Është e qartë se sidomos në fushën e Transfereve Sociale janë të nevojshme ndryshime dhe ristrukturime shumë substanciale. Rreth 152 milionë euro është kosto vjetore për shpenzime të reja në fushën e transfereve sociale. Kjo është një rritje prej rreth 29% krahasuar me atë që ka parashikuar KAMSH-i. Duke parë tabelën 4 mund të shohim se sipas KAMSH-it, shpenzimet për Kujdesin Social pritet të zvogëlohen për 20 milionë në vitin 2024 në krahasim me shpenzimet e pritshme buxhetore në vitin 2021. Siç u theksua tashmë, kjo kategori tashmë paraqet një barrë të rëndë për buxhetin e konsoliduar, një barrë që është përtej kapaciteteve buxhetore dhe ka një rëndësi të jashtëzakonshme për reformën dhe ristrukturimin e thellë të këtij destinimi buxhetor. Auditimi rigoroz i përfituesve në lidhje me përshtatshmërinë e tyre për t'i gëzuar këto benefite mund të krijojë hapësirë për vija të reja të shpenzimeve në këtë fushë, por duket shumë e vështirë që të akomodohen të gjitha shpenzimet e reja që ka treguar qeveria me programin e saj.

Për sa i përket subvencioneve, element i ri është mbështetja për 2000 ndërmarrës të rinj, e cila së paku mund të arrijë në 20 milionë euro në vit. Me shumë gjasa kjo mund të akomodohet brenda buxhetit të parashikuar për ekonominë, ku intervenimet do të rriten në vitin 2024 për 17% ose 60 milionë euro (tabela 4). Një masë tjetër e rëndësishme e propozuar me Programin e qeverisë është çmimi minimal i garantuar për produktet bujqësore, por nuk vlerësohet për nga niveli i orientimit dhe nuk përfshihet në këtë vlerësim të kostove.

Projektet infrastrukturore – rrugët dhe hekurudhat do të financohen me shpenzime kapitale të parashikuara dhe duke shfrytëzuar klauzolën për investime, e cila do të ndërlidhet me borxhin e jashtëm dhe kreditimin. Kjo tashmë është trajtuar më lart. Në mënyrë të ngjashme, pritet që intervenimet në shëndetësi dhe në arsim nuk janë buxhetuar mjaftueshëm me KAMSH-in dhe se këta sektorë do të kërkojnë më shumë intervenime sa i përket vëllimit dhe strukturës. Pritet që shpenzimet për kulturë dhe sport të mund të akomodohen në kuadër të parashikimeve të kornizës së KAMSH-it për periudhën 2022–2024.

## Aneks. Kostot e vlerësuara

**Tabela A1. Skema e shtesave për fëmijë nën moshën 2 vjeç**

Fëmijë nën 2 vjeç	Pagesa në muaj	Muaj në vit	Gjithsej
61,097.00 <sup>†</sup>	20.00 <sup>‡</sup>	12.00	14,663,280.00

**Burimi:** Llogaritjet e autores bazuar në të dhëna zyrtare

<sup>†</sup>Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

<sup>‡</sup>Programi i qeverisë

**Tabela A2 Skema e shtesave për fëmijët nën moshën 16 vjeç (duke përjashtuar fëmijët nën moshën 2 vjeç)**

Fëmijët nën moshën 16 vjeç (duke përjashtuar fëmijët nën moshën 2 vjeç)	Pagesa në muaj	Muaj në vit	Gjithsej
467,455.00 <sup>†</sup>	10.00	12.00	56,094,600.00

**Tabela A3. Skema e shtesave për gratë e papuna**

<b>A</b>	Gra në moshë pune <sup>†</sup>		614,176
<b>B</b>	Gra në moshë riprodhuese (15-49) <sup>†</sup>		480,061
<b>C</b>	Gra aktive në fuqinë punëtore <sup>†</sup>		127,000
<b>D</b>	Gra të punësuar <sup>†</sup>		83,312
<b>E</b>	Gra te papuna <sup>†</sup>		43,688
<b>F</b>	Gra pasive në fuqinë punëtore <sup>†</sup>		487,176
<b>G</b>	Lindje <sup>†</sup>		21,798
<b>H (D/B)</b>	Pjesa e vlerësuar e punësimit		0.17
<b>I (G*H)</b>	Nënat e reja të punësuar të vlerësuara		3,783
<b>J (G-I)</b>	Kërkuesit e vlerësuar		18,015
<b>Estimated claimants</b>	Pagesa në muaj	Muaj në vit	Total
<b>18,015</b>	250 <sup>‡</sup>	6 <sup>‡</sup>	27,022,500.00

**Burimi:** Llogaritjet e autores bazuar në të dhëna zyrtare

<sup>†</sup>Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK);<sup>‡</sup> Programi i qeverisë

**Tabela A4. Implikimet e vlerësuara të rritjes së pagës minimale**

Numri i përfituesve të skemave sociale të lidhura me pagën minimale	Pagesa në muaj (ndryshimi në pagën minimale; 250-170=80)	Muaj në vit	Gjithsej
38,216 <sup>†</sup>	80 <sup>‡</sup>	12.00	36,687,360.00

**Burimi:** Llogaritjet e autores bazuar në të dhëna zyrtare

<sup>†</sup>Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

<sup>‡</sup>Programi i qeverisë

**Tabela A5 Implikimet e vlerësuara të skemës së subvencionimit të pagave (për punësimet e reja në tregun e punës)**

Numri i punësimeve të reja në tregun e punës	Pagesa në muaj	Muaj në vit	Gjithsej
18,000 <sup>†</sup>	250 <sup>‡</sup>	12.00	54,000,000.00

**Burimi:** Llogaritjet e autores bazuar në të dhëna zyrtare

<sup>†</sup>Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

<sup>‡</sup>Programi i qeverisë

**Tabela A6. Skema për banim të përbalueshëm**

Skema për banim të përbalueshëm	Gjithsej në vit
	22,000,000.00
Siç vlerësohet nga programi i qeverisë	

**Burimi:** Programi i qeverisë

**Tabela A7 Skema për mbështetjen e ndërmarrësve të rinj**

	Numri i granteve	Shuma	Kosto totale
Sipas programit të qeverisë (shuma e grantit supozohet nga autorët)	2,000.00 <sup>†</sup>	10,000.00 <sup>†</sup>	20,000,000.00

**Burimi:** Llogaritjet e autorëve

<sup>†</sup> Supozimet e autorëve

<sup>‡</sup> Programi i qeverisë

**Tabela A8. Skema e bursave**

	<b>Nr</b>	<b>Shuma</b>		<b>Kosto vjetore</b>
<b>1000 bursa</b>	1,000.00 <sup>†</sup>	100.00 <sup>†</sup>	12	1,200,000.00

**Burimi:** Llogaritjet e autorëve

<sup>†</sup> Supozimet e autorëve

<sup>‡</sup> Programi i qeverisë

**Tabela A9. Kostot e funksionimit për 160 kopshte**

		<b>Numri i fëmijëve aktualisht në kopshte (7%) (38%)</b>	<b>Numri i fëmijëve të planifikuar për t'u vendosur në kopshte (24%; 64%)</b>	<b>Diferenca (C-D)</b>
<b>Numri i fëmijëve (0-5 vjeç)</b>	169,325	11,852.79	40,638.13	28,785.34
<b>Numri i fëmijëve (3-6)</b>	116,269	44,182.58	74,412.76	30,230.18
<b>Mbivendosja e vlerësuar mes dy grupmoshave</b>				16,800.00
<b>Totali duke përjashtuar mbivendosjen e vlerësuar</b>				42,215.52
<b>Kosto vjetore për çdo fëmijë</b>				2,000
<b>Gjithsej</b>				84,431,047.50
<b>Paguar nga familjet</b>				55,724,491.35
<b>Paguar nga qeveria</b>				28,706,556.15





**RIINVEST**  
INSTITUTI PER HULUMTIME ZHVILLIMORE  
INSTITUTE FOR DEVELOPMENT RESEARCH

 **KONRAD  
ADENAUER  
STIFTUNG**